



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E LARTË

Këshilli i Gjykatës

Nr. 24 Prot.

Tiranë, më 10.10.2025

V E N D I M

Nr. 15, datë 10/10/2025

P Ë R

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 6, DATË 21.03.2024, “PËR CAKTIMIN E GJYQTARËVE NË PËRBËRJE TË KOLEGJEVE TË GJYKATËS SË LARTË SI DHE CAKTIMIN E GJYQTARËVE NË PËRBËRJE TË TRUPAVE GJYKUESE TË SECILIT KOLEGJ”

Në mbështetje të pikave 2 dhe 3 të nenit 23 si dhe të shkronjës “ç” të nenit 38 të ligjit nr. 98/2016, “*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*” (i ndryshuar), bazuar në mendimin e dhënë nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për ndarjen e gjyqtarëve në kolegje dhe përbërjen e trupave gjykuese në këtë Gjykatë,

- duke vlerësuar me përgjegjësi situatën e krijuar në Kolegjin Civil, që aktualisht përbëhet nga 5 gjyqtarë, për shkak të mungesës së gjyqtarës Vojsava Kola, si rezultat i marrjes së lejes së lindjes dhe i një vendi vakant që është krijuar në Kolegjin Civil, procedurë e cila ende nuk është mbyllur nga KLGJ për emërimin e gjyqtarit tjetër;

- me qëllim që të mos pengohet veprimtaria gjyqësore e Kolegjit Civil, si dhe të garantohet vijueshmëria normale e shqyrtimit të çështjeve gjyqësore prej tij;

Këshilli i Gjykatës së Lartë, në mbledhjen e datës 10.10.2025,

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 6, datë 21.03.2024 “*Për caktimin e gjyqtarëve në përbërje të kolegjeve të Gjykatës së Lartë si dhe caktimin e gjyqtarëve në përbërje të trupave gjykuese të secilit koleg*” bëhen ndryshimet si vijon:

- 1) Në Kolegjin Civil, **Trupi gjykues nr. 2** përbëhet nga gjyqtarët si më poshtë:

Trupit gjykues nr. 2

Valbon Çekrezi

Margarita Buhali

Artur Kalaja/Ervin Pupe/Enton Dhimitri

2. Duke filluar nga muaji Nëntor 2025, rendi i shqyrtimit të çështjeve civile të **Trupit Gjykues nr. 2** përcaktohet në mënyrë periodike, mbi bazë javore, sipas skemës si më poshtë:

- a) për çështjet e planifikuara në javën e parë, në përbërje të trupit gjykues do të jetë gjyqtari Artur Kalaja;
- b) për çështjet e planifikuara në javën e dytë, në përbërje të trupit gjykues do të jetë gjyqtari Ervin Pupe;
- c) për çështjet e planifikuara në javën e tretë, në përbërje të trupit gjykues do të jetë gjyqtari Enton Dhimitri.

Mbas javës së tretë të muajit Nëntor 2025, rendi i shqyrtimit të çështjeve vijon të përsëritet në mënyrë ciklike, duke ndjekur skemën e përcaktuar më lart.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, gjyqtarët e Kolegjit Administrativ Sokol Ngresi dhe Asim Vokshi, të cilët janë ngarkuar edhe me shqyrtimin e çështjeve civile, ndërpresin shqyrtimin e mëtejshëm të çështjeve civile si anëtarë të trupit gjykues, i përbërë nga gjyqtarët Margarita Buhali dhe Valbon Çekrezi, me përjashtim të çështjeve për të cilat ky trup gjykues ka shpallur deri në fund të muajit Tetor 2025, datat e shqyrtimit të tyre në dhomë këshillimi por ende nuk kanë përfunduar apo ka filluar gjykimi dhe është vendosur kalimi në seancë gjyqësore.
4. Vendimi nr. 10, datë 27.06.2025 *“Për krijimin e trupit gjykues të përkohshëm në Kolegjin Civil dhe caktimin në përbërje të tij të dy gjyqtarëve të Kolegjit Administrativ”*, shfuqizohet.
5. Ky vendim t’i komunikohet gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, Njesisë së Shërbimit Ligjor, Kancelarit, si dhe të publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet deri në rikthimin në punë të gjyqtarës Vojsava Kola, si dhe emërimin e gjyqtarit të ri në vendin e shpallur vakant.

KËSHILLI I GJYKATËS

ANËTAR

ILIR PANDA

ANËTAR

KELMENT GRECA

KRYETAR

SOKOL SADUSHI